




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË
MINISTARSTVO ZA TRGOVINU I INDUSTRIJU
MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY

PROFILI I SEKTORIT TË INDUSTRIË SË TEKSTILIT







PROFILI I SEKTORIT TË INDUSTRIË SË TEKSTILIT

Mars 2014

Mirënjohjet dhe Falenderimet

Ky raport është financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Finlandës brenda kornizës së angazhimeve përmes projektit “Ndihmë Tregtisë”, implementuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).



MINISTRY FOR FOREIGN
AFFAIRS OF FINLAND

Për realizimin e këtij raporti kontribut i veçant është dhënë nga:

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë:

Kabineti i Ministrit

Departamenti i Industrisë

Departamenti i Integritimeve Evropiane dhe Koordinimit të Politikave

Agjencia për Mbështetje të Investimeve dhe Ndërmarrjeve në Kosovë

Anketimi në terren realizuar nga TNS Index Kosova, Agjenci për hulumtime sociale, të mediave dhe marketingut

Kontrolli i Cilësisë:

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) Kosovë

Njësia për Politika, Hulumtime, Çështje gjinore dhe komunikim

Njësia për Zhvillim Gjithpërfshirës

Projekti “Ndihmë Tregtisë”

Petrit Gashi, Phd – Konsulent i Jashtëm

Autore

Artane Rizvanolli

Përkthyes në gjuhën Shqipe:

Hyjnor Jasiqi

Dizajni: “XHAD Studio”, Prishtinë

Shtypi: „Grafika Rezniciq“ Prishtinë

Si dhe një falenderim i veçantë për të gjithë respondentët e përfshirë në hulumtim.

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të pjesëmarrësve dhe të autorëve, dhe në asnjë mënyrë nuk përfaqësojnë qëndrimet zyrtare të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Finlandës.

E drejta autoriale © 2014. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Përmbajtja

Mirënjohtet dhe Falenderimet.....	2
1.Hyrje	5
2.Karakteristikat themelore të ndërmarrjeve dhe industrisë	6
2.1. Madhësia dhe përbërja e sektorit	6
2.2. Madhësia dhe vendndodhja gjeografike e ndërmarrjeve të sektorit	9
2.3. Pronësia e kompanive të sektorit	11
3. Prodhimi.....	12
3.1. Kontributet	12
3.2. Rezultati	13
3.3. Shfrytëzimi i kapaciteteve	14
4. Tregjet, eksportet dhe pengesat e eksportit	16
5. Punësimi dhe kapacitetet njerëzore	20
5.1. Punësimi, pagat dhe struktura demografike e punëtorëve	20
5.2. Kualifikimet e fuqisë punëtore	22
6. Asetet, investimet dhe inovacioni	24
7. Mjedisi afarist	27
7.1. Pengesat për zhvillimin e ndërmarrjeve; perceptimet e ndërmarrjeve	27
Konkluzionet.....	34
Referencat.....	36



1. Hyrje

Ky profil i sektorit ofron informata themelore lidhur me zhvillimin e sektorit të tekstilit në Kosovë gjatë kohëve të fundit. Ky profil mbulon prodhimin e tekstilit, prodhimin e veshjeve, përpunimin e lëkurave dhe prodhimin e produkteve të lëkurës (sipas kodeve 17, 18 dhe 19 të Nomenclature des Activités Économiques dans la Communauté Européenne – NACE Rev. 1).

Profili bazohet kryesisht në burime zyrtare të të dhënave; në një hulumtim të ndërmarrjeve të kryer nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) për qëllime të këtij raporti; dhe në intervista të thukëta me menaxhmentin e lartë të njëjës nga kompanitë më të suksesshme në këtë sektor në Kosovë - Kosovatex. Diskutimet mbi karakteristikat e përgjithshme të sektorit, përfshirë madhësinë dhe përbërjen e tij, bazohen në të dhënat në dispozicion të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) dhe Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK). Bilanci tregtar i sektorit është siguruar nga Doganat e Kosovës. Të gjithë treguesit e karakteristikave dhe performancës së sektorit në nivel ndërmarrjesh janë grumbulluar përmes anketës së realizuar nga UNDP gjatë muajve tetor dhe nëntor të vitit 2013. Mostra e kësaj ankete përbëhet nga 120 prej 182 kompanive aktive në vitin 2012 sipas bazës së të dhënave të ATK-së. Marrë parasysh se sektori kryesisht përbëhet nga kompanitë e klasifikuara si 'mikro', me anketë u mëtua mbulimi i të gjitha ndërmarrjeve të vogla, të mesme dhe të mëdha, si dhe kompanitë mikro të përzgjedhura rastësisht. Mostra përfundimisht ngërtheu 101 nga 157 kompanitë mikro dhe 19 nga 25 ndërmarrjet e vogla, të mesme dhe të mëdha.

Për qëllime të këtij raporti, aktivitetet e këtij sektori do të përkufizohen si në vijim: (i) prodhimi i tekstilit, që në Kosovë kryesisht përbëhet nga prodhimi i mbathjeve, (ii) prodhimi i veshjeve, kryesisht i rrobave të punës dhe rrobave tjera të sipërme, dhe (iii) prodhimi i produkteve të lëkurës, kryesisht i mbathjeve. Fuqia punëtore në dispozicion dhe kostoja e ulët e fuqisë punëtore (më e ulëta në rajon) në njërin anë, dhe afërsia gjeografike me tregun e Bashkimit Europian (BE) në anën tjetër, përbëjnë garanci për zhvillimin potencial të sektorit të tekstilit në Kosovë.


2. Karakteristikat themelore të ndërmarrjeve dhe industrisë

2.1. Madhësia dhe përbërja e sektorit

Sipas bazës së të dhënave të ATK-së, gjatë vitit 2012 në Kosovë kanë qenë të regjistruara 182 ndërmarrje aktive nën kodet 17, 18 dhe 19 të NACE Rev.1. Këtu përfshihen ndërmarrjet aktive në prodhimin e tekstilit, prodhimin e veshjeve, përpunimin e lëkurës dhe prodhimin e produkteve të lëkurës.


Pak më shumë se gjysma e këtyre ndërmarrjeve merren me prodhimin e veshjeve, përcjellë nga prodhuesit e tekstilit (36%), ndërsa me prodhimin e produkteve të lëkurës merren vetëm 10% të kompanive (Figura 1). Shqyrtimi i numrit të kompanive në pronë të grave (apo në pronësi të pjeshme të tyre) sugjeron se kompanitë e tilla kryesisht përqendrohen në prodhimin e veshjeve (64%), e më pak në prodhim të tekstilit (29%) dhe lëkurës (7%).

Figura 1: Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas veprimtarisë kryesore




Megjithatë, shqyrtimi më i thuktë i të dhënave të punësimit nga kompanitë aktive (Figura 2) zbulon se madhësia e nënsektorëve të veshjes dhe prodhimit të tekstilit është e ngjashme, duke qenë se të njëjtët mbulojnë gjithsej 87% të punësimit në tërë sektorin, në krahasim me nënsektorin relativisht më të vogël të lëkurave (13% të punësimit të gjithmbarshëm).

Figura 2: Ndarja e punësimit sipas veprimtarisë kryesore




Sipas të dhënave të ndara në nivel të katër shifrave të NACE Rev.1, pesë veprimtaritë kryesore të sektorit të tekstilit në Kosovë janë: (i) prodhimi i veshjeve të sipërme, veshjeve të p.k.t. (NACE 1822, 33% të kompanive); (ii) prodhimi i tekstilit, p.k.t. (NACE 1754, 11% të kompanive); (iii) veshjet dhe aksesorët, p.k.t. (NACE 1824, 10% të kompanive); (iv) prodhimi i rrobave të punës (NACE 1821, 7% të kompanive); dhe (v) prodhimi i mbathjeve (NACE 1930, 7% të kompanive).

Figura 3: Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas veprimtarisë kryesore (4 shifra të NACE)¹



Prodherimi i veshjeve të sipërme p.k.t. (NACE 1822) është gjithashtu nënsektori më i madh sa i përket punësimit, duke qenë se mbulon pothuajse një të tretën e punësimit të gjeneruar nga sektori i tekstilit. Prodherimi i mbathjeve (NACE 1930), prodherimi i tekstilit p.k.t. (NACE 1754) dhe prodherimi i mbathjeve (1821) gjithashtu janë mes pesë veprimtarive kryesore, megjithëse mbulojnë një pjesë relativisht më të vogël të tregut. Megjithatë, përgatitja dhe tjerja e fijeve të leshit (NACE 1712) tani po shfaqet si nënsektori i dytë më i madh, falë një kompanie të madhe - Remateks.


Figura 4: Ndarja e punësimit sipas veprimtarisë kryesore (katër shifra të NACE)²



- 1 Pjesa e mbetur prej 32% janë biznese të angazhuara në veprimtari të ndryshme, që mbajnë një pjesë mjaft të vogël (të parëndësishme) të tregut.
- 2 Pjesa e mbetur prej 19% janë të punësuar në biznese në veprimtari të ndryshme që mbajnë një pjesë të vogël (të parëndësishme) të tregut.

Proporcioni i kompanive të regjistruara gjatë tri vite e gjysmë të fundit (gjatë viteve 2010-2012 dhe gjysmës së parë të vitit 2013) është konsistente me ndarjen e kompanive në tërë sektorët në vitin 2012 (Figura 5). Rreth tri të katërtat e kompanive të saporegjistruara në këtë sektor kanë për veprimtari prodhimin e veshjeve (NACE 18), ndërsa nga pjesa e mbetur 22% janë në prodhimin e tekstit.

Figura 5: Numri i ndërmarrjeve të saporegjistruara sipas veprimtarisë



Burimi: ARBK(2013)


Në vitin 2012, sektori i tekstit punësonte 1,453 individë, apo rreth 0.7% të të gjithë punëtorëve të regjistruar në Kosovë (ATK, 2013). Ngjashëm me pjesën tjetër të sektorit privat në Kosovë, shumica e ndërmarrjeve aktive (86%) në sektorin e tekstit janë ndërmarrje mikro, d.m.th. me më pak se 10 punëtorë³(Figura 6). Pjesa e mbetur kryesisht përbëhet nga kompanitë e vogla (mes 10 dhe 49 punëtorë), ndërsa vetëm 2% janë kompani të mesme dhe të mëdha (që punësojnë 50 apo më shumë punëtorë). Megjithatë, ndikimi i kompanive të mëdha në punësimin e ofruar nga ky sektor është i madh. Në fakt, katër ndërmarrjet më të mëdha (ndërmarrja e vetme e mesme dhe ndërmarrjet e mëdha) mbulojnë 50% të punësimin të tërë sektorit, ndërsa vetëm dy ndërmarrjet më të mëdha prej këtyre katër të fundit ofrojnë 40% të të gjitha vendeve të punës në këtë sektor.

3 Madhësia e firmave mund të jetë më e lartë se ajo e paraqitur pasi që disa firma shfaqin tendencë të mosparaqitjes së numrit të plotë të punonjësve.

2.2. Madhësia dhe vendndodhja gjeografike e ndërmarrjeve të sektorit

Ngjashëm me pasqyrën e tërë sektorit privat në Kosovë, shumica e 182 ndërmarrjeve aktive në vitin 2012 ishin ndërmarrje mikro (Figura 6).


Figura 6: Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas madhësisë



Burimi: ATK (2013)

Përqendrimi gjeografik i kompanive në sektorin e tekstilit është evident (Figura 7). Mbi dy të tretat e ndërmarrjeve që merren me prodhimin e tekstilit gjenden në tri rajone: Prizren, Gjakovë dhe Prishtinë.

Figura 7: Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas rajonit



Burimi: ATK (2013)

Rubrika 1: Histori e suksesit: Kosovatex

Kosovatex është prodhues i xhinseve që ka rreth 300 të punësuar dhe gjendet në periferi të Prishtinës. Dikur prodhues madhor i fijos së pambukut i themeluar më 1952, kjo kompani është privatizuar më 2006 përmes një spinofi special nga Ecolog International. Më 2010, në Kosovatex është bërë një investim i konsiderueshëm përmes instalimit të një fabrike të prodhimit të xhinseve të teknologjisë më bashkëkohore. Që nga viti 2010, kompania ka filluar me prodhimin e xhinseve për eksport dhe shitjet e saj kanë parë vetëm rritje.

Kompania prodhon disa produkte ekskluzivisht për brende të njohura italiane dhe gjermane si Pierre Cardin, Cabano, Pioneer, Otto Kern, etj. Më 2013, ajo ka eksportuar 300,000 xhinse me destinacion BE-në, përfshirë Gjermaninë, Italinë dhe Austrinë. Pas futjes së linjës së katërt të prodhimit në fillim të vitit 2014, kapaciteti i prodhimit të kompanisë është rritur në 450,000-500,000 palë xhinse në vit.

Kosovatex prodhon produkte sipas specifikave të konsumatorëve dhe duke shfrytëzuar materiale të përzgjedhura nga konsumatori, por gjithashtu mund të ofrojë shërbime për zhvillim të produkteve për ta. Përmes gjashtë departamenteve të tij, ai ofron modelim, prerje, qepje, tharje, realizim (larje, ngjyrosje dhe trajtime speciale) si dhe kontroll të cilësisë. Të gjitha veshjet e prodhuara në këtë fabrikë i nënshtrohen kontrollit të rreptë të cilësisë së materialit (inspektim, hijezim, testit të tkurrjes, gjerësisë dhe peshës) si dhe materialit përfundimtar.

Produktet e ndërmjetme, si gëzofët, janë të importuara ekskluzivisht nga Gjermania, Turqia dhe Maqedonia meqë ato ose nuk janë në dispozicion në vend, ose ato që janë nuk i plotësojnë standardet e cilësisë. Kufizimi më serioz për zhvillimin e biznesit që e ka hasur Kosovatex është mungesa e punonjësve të kualifikuar. Sipas tyre, shpeshherë është e pamundur që të gjenden teknologë të përshtatshëm, teknikë të kimisë, si dhe specialistë për modelim, organizim të qepjes dhe ngjyrosje në tregun e Kosovës. Kjo sfidë tejkalohet përmes punësimit të stafit nga shtetet fqinje, Italia apo Turqia, edhe për të punuar (në periudhë afatshkurtrë apo afatgjatë) edhe për ta trajnuar stafin vendor. Prandaj, të gjithë punonjësit e Kosovatex duhet të kryejnë trajnime në vend të punës në shkathtësi specifike të prodhimit. Megjithatë, përkundër tërë kësaj, kompania gjithashtu përballlet me probleme në gjetjen e teknikëve të kualifikuar të makinerisë.

Përparësia konkurruese e Kosovatex duket të jetë në kombinim të disa faktorëve. Cilësia e teknologjisë së tyre dhe cilësisë së fuqisë punëtore – të cilën e arrijnë përmes investimeve të vazhdueshme në zhvillim të stafit dhe në "importimin e ekspertëve – garanton prodhim të lartë të produkteve tejet cilësore që iu bënë të mundur plotësimin e kërkesës së kompanive të mëdha evropiane. Dy faktorë të tjerë të rëndësishëm të suksesit janë kapitali i pronarit dhe mundësitë e rrjetëzimit; ndonëse, siç është theksuar nga menaxhmenti i kompanisë, mundësitë e rrjetëzimit nuk kanë vlerë të madhe nëse një kompani nuk mund të prodhojë produkte të cilësisë së lartë. Kur janë pyetur për përparësinë konkurruese të Kosovës mbi prodhuesit e mëdhenj e të lirë në Azi, si për shembull në Kinë, menaxhmenti ka theksuar se, përveç vendndodhjes gjeografike, Kosova mund të konkurrojë me cilësinë e produkteve të saj.

2.3. Pronësia e kompanive të sektorit

Sipas rezultateve të anketës, shumica dërmuese e kompanive të këtij sektori janë të organizuara si ndërmarrje individuale (93%); ato janë kryesisht pronë private; shumica dërmuese janë pronë e qytetarëve të Kosovës, kryesisht shqiptarë (95%) dhe turq (4%). Rreth një e katërta e ndërmarrjeve të anketuara janë në pronësi të së paku një gruaje. Nga këto ndërmarrje, 54% janë pronë ekskluzive e grave. Moshë mesatare e pronarëve (kryesorë) të kompanive që merren me tekstil dhe lëkura është 45 vjet. Rreth dy të tretat e pronarëve janë mbi moshën 40 vjeç, ndërsa pronarët nën moshën 30-vjeçare janë mjaft të rrallë (Tabela 1).

Tabela 1: Moshë e pronarit (kryesor)

Moshë	Përq. (%)
25-29 vite	8%
30-39 vite	24%
40-49 vite	45%
50 apo më shumë vite	23%
Gjithsej	100%

Burimi: Anketa e UNDP (2013)

Rreth dy të tretat e pronarëve kryesorë të kompanive të këtij sektori kanë të kryer shkollimin e mesëm (si nivel më të lartë të shkollimit); pjesa tjetër kanë tituj terciarë apo postdiplomik (25%), ose nuk e kanë të kryer as shkollimin e mesëm (13%). Numri i pronarëve burra dhe gra që kanë kryer arsimim terciar është shumë i ngjashëm; megjithatë, mes pronarëve që nuk e kanë kryer shkollimin terciar vihet në pah se gratë janë mesatarisht më të paarsimuar se burrat (Tabela 2).

Tabela 2: Niveli i arsimimit të pronarëve (në %)

Niveli i arsimimit	I përgjithshëm	Gratë
Më pak se i mesëm	13%	32%
I mesëm dhe më i ulët se terciar	63%	42%
Terciar dhe më i lartë	24%	26%
Gjithsej	100%	100%

Burimi: Anketa e UNDP (2013)

3. Prodhimi

3.1. Kontributet⁴

Lënda e parë dhe mallrat e papërpunuara përbëjnë pjesën më të madhe të koston së kontributeve të ndërmarrjeve mikro dhe të vogla (75%, përkatësisht 63%), dhe rreth 46% të koston për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha. Në anën tjetër, koston për paga shtohen me madhësinë e kompanisë, nga 14% në ndërmarrje mikro deri tek 36% në ndërmarrje të mesme dhe të mëdha (Tabela 3, Paneli A). Dallime ekzistojnë edhe mes sektorëve (Tabela 3, Paneli A). Për shkak të dallimeve në kosto të lëndës së parë, përpjesa e kostove për paga - më e ulëta në prodhimin e produkteve të lëkurës (9%) - është shumë më e ulët se sa në prodhimin e tekstileve dhe veshjeve (38%, përkatësisht 31%).

Tabela 3: Kostoja mujore e kontributeve (në €)

A: Kostoja mesatare e kontributeve sipas madhësisë së kompanisë

Madhësia e ndërmarrjes	Lënda e parë dhe produkte papërpunuara	Kosto të pagave	Energji	Ujë	Karburante	Tjera
Mikro (≤ 9 punëtorë)	3,946	758	101	17	190	338
Të vogla (10-49 punëtorë)	13,383	4,093	1,080	137	2,880	/
Të mesme dhe të mëdha (≥50 punëtorë)	66,485	50,850	8,580	4,326	12,050	/
Mesatarja e sektorit	7,511	3,524	572	221	946	338

B: Kostoja mesatare e kontributeve sipas veprimtarisë së kompanisë

Madhësia e ndërmarrjes	Lënda e parë dhe produkte papërpunuara	Kosto të pagave	Energji	Ujë	Karburante	Tjera
Prodhimi i tekstit	4,741	5,041	1,104	580	1,625	200
Prodhimi i veshjeve	4,627	2,448	238	27	369	314
Prodhimi i produkteve të lëkurës	42,793	4,736	630	143	1,951	800
Mesatarja e sektorit	7,511	3,524	572	221	946	338

Burimi: Anketa e UNDP (2013)

Mallrat e papërpunuara dhe lëndët e para që shfrytëzohen nga ndërmarrjet kosovare kryesisht vijnë nga importi. Gjashtëdhjetë për qind e kompanive të anketuara raportojnë se lëndët e para dhe mallrat e papërpunuara i sigurojnë ekskluzivisht përmes importit⁵ (Tabela 4). Furnizimi me lëndët e para dhe mallrat e papërpunuara të importuara kryesisht bëhet përmes prodhuesve të huaj apo tregtarëve lokalë, ndërsa në disa raste të rralla raportohet se ato janë blerë nga tregtarët ndërkombëtarë. Pjesa e mbetur e kompanive janë të ndara pothuajse në mënyrë të barabartë: 19% varen nga furnizimi lokal (prodhimi i tyre apo prodhuesit tjerë vendorë), 21% shfrytëzojnë

⁴ English: Inputs

⁵ Edhe këtu, në rastin e Kosovates, arsye për këtë u raportua të jetë disponueshmëria dhe/ose cilësia e produkteve të ndërmjetme vendore

edhe lëndën e parë dhe mallrat e papërpunuara që prodhohen në vend edhe ato që importohen.

Tabela 4: Struktura e lëndës së parë dhe materialeve papërpunuara

Burimi	Përqindja e kompanive
Ekskluzivisht prodhim vendor	19%
<i>Prodhim vetanak</i>	8%
<i>Prodhues vendorë</i>	11%
Përzjerje i prodhimeve vendore dhe importeve	21%
Ekskluzivisht import	60%
<i>Tregtarë vendorë</i>	25%
<i>Tregtarë ndërkombëtarë</i>	7%
<i>Prodhues të huajë (drejtpërdrejt)</i>	28%

Burimi: Anketa e UNDP (2013)


Kontributet e importuara janë kryesisht mallra të papërpunuara, si pambuk, lesh dhe fije të tjera, lëkurë dhe penj për qepje. Vendet e përmendura më së shpeshti si vende nga të cilat importohen këto mallra ishin Turqia, përcjellë nga Maqedonia, Italia, Gjermania dhe Kina.

3.2. Rezultati⁶

Vlera e raportuar mesatare e rezultatit të kompanive të këtij sektori për vitin 2012 ishte €244,000. Prodhimtaria e produkteve të lëkurës kishte rezultatin më të lartë mesatar prej €963,000, përcjellë nga tekstili (€406,000) dhe veshjet (€53,300)⁷. Në vitin 2012, dy të tretat e ndërmarrjeve kishin vlerë prodhimi më të ulët se sa €25,000, ndërsa 10% kishin vlerë prodhimi mes €100,000 dhe €10 milionë (Figura 8). Vlera e rezultatit të sektorit është shtuar për 18% nga viti 2011 në vitin 2012, që duket të ketë qenë rezultat i shtimit të prodhimtarisë së tekstileve dhe produkteve të lëkurës.

Figura 8: Vlera vjetore e rezultatit sipas veprimtarisë së kompanisë

A: Vlera e rezultatit në vitin 2012 (në €)




Burimi: Anketa e UNDP (2013)

⁶ Anglisht: Output

⁷ Statistikat e prodhimit janë kalkuluar në bazë të pikave mesatare të dhjetë intervaleve të vlerave prodhuese, të raportuara prej 112 nga 120 kompanitë e përfshira në mostër.

B: Vlera e rezultatit në vitin 2011 (në €)



Burimi: Anketa e UNDP (2013)

3.3. Shfrytëzimi i kapaciteteve

Sipas rezultateve të anketës, rreth vetëm 10% e kompanive shfrytëzojnë të gjitha kapacitetet e tyre. Shfrytëzimi i kapaciteteve nuk ka ndryshuar dukshëm mes viteve 2011 dhe 2012. Niveli mesatar i shfrytëzimit të kapaciteteve në sektorë në vitin 2011 ishte 56%, ndërsa në vitin 2012 57%. Rreth gjysma e të gjitha kompanive shfrytëzojnë mes 60% dhe 100% të kapaciteteve të tyre (Tabela 5).

Tabela 5: Shfrytëzimi i kapaciteteve, 2011 dhe 2012

Shfrytëzimi i kapaciteteve	Përqindja e kompanive	
	2011	2012
Nën 20%	9.3%	6.0%
20%-39%	16.9%	20.5%
40%-59%	25.4%	23.9%
60%-79%	23.7%	23.1%
80%-100%	24.6%	26.5%
Gjithsej	100%	100%

Burimi: Anketa e UNDP (2013)

Niveli mesatar i shfrytëzimit të kapaciteteve dallon paksa mes kompanive të nënsektorëve të ndryshëm dhe kompanive të madhësive të ndryshme. Në vitin 2012, niveli i shfrytëzimit të kapaciteteve lëvizte nga 51% në prodhimtari të tekstit në 61% në prodhim të veshjeve (Tabela 6, Paneli A). Dallimet në shfrytëzim të kapaciteteve mes kompanive të madhësive të ndryshme nuk janë të mëdha, por shfrytëzimi i kapaciteteve është relativisht më i ulët në kompani të mesme dhe të mëdha se sa në kompani mikro dhe të vogla (Tabela 6, Paneli B).

Tabela 6: Dallimet në shfrytëzim të kapaciteteve, 2012

A: Shfrytëzimi mesatar i kapaciteteve sipas sektorit

Shfrytëzimi i kapaciteteve	Përqindja (%)
Prodhimi i tekstileve	51%
Prodhimi i veshjeve	61%
Prodhimi i produkteve të lëkurës	54%
Mesatarja	57%

B: Shfrytëzimi mesatar i kapaciteteve sipas madhësisë së kompanisë


Shfrytëzimi i kapaciteteve	Përqindja (%)
Mikro (≤ 9 punëtorë)	57%
Të vogla (10-49 punëtorë)	59%
Të mesme dhe të mëdha (≥ 50 punëtorë)	50%
Mesatarja	57%

Burimi: Anketa e UNDP (2013)

4. Tregjet, eksportet dhe pengesat e eksportit

Nga të gjitha kompanitë e anketuara të sektorit të tekstilit, rreth 45% i shesin produktet e veta ekskluzivisht tek distributorët/shitësit me shumicë apo pakicë, ndërsa 22% i shesin produktet e tyre ekskluzivisht tek konsumatorët fundorë (Figura 9). Pjesa e mbetur prej 33% të kompanive ia shet produktet e veta blerësve të ndryshëm, përfshirë edhe blerësit e huaj.


Figura 9: Struktura e blerësve



Burimi: Anketa e UNDP (2013)

Sipas rezultateve të anketës, rreth 10% të kompanive të këtij sektori eksportojnë ndonjë produkt të tyre. Në pyetjet lidhur me planet e tyre për eksportim për kompanitë që aktualisht nuk eksportojnë, rreth 40% u përgjigjen se nuk kanë plane të tilla. Megjithatë, pjesa tjetër raportoi se do dëshironin të eksportojnë, apo se planifikojnë të eksportojnë në të ardhmen, por konsiderojnë se ka shumë pengesa, andaj ata nuk janë të gatshëm për të konkurruar në tregje të huaja (Figura 10).

Figura 10: Planet për të eksportuar të kompanive që aktualisht nuk eksportojnë




Burimi: Anketa e UNDP (2013)

Nga kompanitë që aktualisht eksportojnë, eksporti mesatarisht mbulon rreth 30% të prodhimit. Vetëm katër kompani eksportojnë 50% apo më shumë të prodhimit të vet, ndërsa dy prej tyre prodhojnë vetëm për eksport. Eksportet kryesore janë lëkurat dhe mbathjet e lëkurës, leshi dhe fijet e tjera, dhe veshjet (p.sh. xhinset dhe çorapët). Vendet kryesore ku eksportohen produktet finale apo të papërpunuara janë Gjermania, Italia, Shqipëria, Bosnja e Hercegovina dhe Serbia.

Përqindja e kompanive eksportuese nuk ka ndryshuar nga viti 2011 në vitin 2012; megjithatë, gjatë të njëjtës periudhë vëllimi i eksporteve është rritur me 4.5%. Rritja e vëllimit të eksportit është nxitur pothuajse ekskluzivisht nga nënsektori i prodhimit të tekstilit (Figura 11).


Figura 11: Vëllimi mesatar i eksportit sipas veprimtarisë së ndërmarrjeve (në milionë €)



Burimi: Anketa e UNDP (2013)

Analizimi i statistikave zyrtare tregon se eksportet e këtij sektori kanë qëndruar relativisht stabile gjatë disa viteve të fundit (Figura 12). Në anën tjetër, në vitin 2012 importet kanë shënuar rënie në krahasim me vitin 2011, gjë që ka rezultuar me rënie të ulët të deficitit tregtar të këtij sektori.

Figura 12: Bilanci tregtar i sektorit (në mijëra €)



Burimi: Doganat e Kosovës (2013)

Kosova ka regjim të tregtisë së lirë dhe gëzon qasje të papenguar në tregje të rëndësishme rajonale dhe botërore (shih Rubrikën 2).


Rubrika 2: Rregulloret tregtare dhe marrëveshjet e tregtisë së lirë

Kosova ka normë të përgjithshme të sheshtë prej 10 % për importe dhe 0 % për eksporte. Nuk ka detyrime doganore në importe të teknologjisë apo produktet e ndërmjetme që rieksporthen (pas përpunimit). Projektligji për përjashtimet nga detyrimet doganore në disa lëndë të para, produkte të ndërmjetme, makineri dhe pajisje dhe paketime që lidhen me tekstilet dhe lëkurën mund të aprovohet nga Kuvendi gjatë vitit 2014.

Kosova është anëtare e marrëveshjes CEFTA dhe gëzon qasje pa detyrime doganore në BE sipas Preferencave Autonome Tregtare dhe në SHBA sipas Sistemit të Përgjithësuar të Preferencave (GSP). Kosova gjithashtu ka marrëveshje të tregtisë së lirë me Turqinë, që do të hyjë në fuqi pas ratifikimit të saj nga Parlamenti i Turqisë. Përveç kësaj, Kosova përfiton nga preferencat tregtare me Japoninë dhe Norvegjinë të cilat përfshijnë vetëm disa kufizime të vogla.

Figura 13 paraqet intensitetin e pengesave, në bazë të raportimit të kompanive të këtij sektori që aktualisht eksportojnë. Intensiteti është matur në shkallë nga 0 deri 100, me atë që 0 paraqet nivelin më të ulët të intensitetit dhe 100 paraqet nivelin më të lartë të tij. Pengesat e eksportit me nivelin më të lartë të intensitetit janë kostot e transportit, procedurat doganore, garancitë bankare të kushtueshme, dhe vështirësitë në arritjen e standardeve ndërkombëtare të cilësisë.

Figura 13: Pengesat për eksportim



Burimi: Anketa e UNDP (2013)

Kostoja e transportit dhe koha dhe kostoja (e transaksionit) për përmbushjen e procedurave doganore janë duke u shqyrtuar aktualisht nga qeveria e Kosovës. Kostoja e transportit pritet të bie me përfundimin e Autostradës R7 që lidhë Kosovën me Shqipërinë dhe Serbinë dhe Autostradën R6 që lidhë Kosovën me Maqedoninë, ndërtimi i së cilës pritet të fillojë në vitin 2014. Në anën tjetër, korniza rregullative për tregti ndërkombëtare rishtas është reformuar dhe numri i dokumenteve që nevojiten për eksportim do të zvogëlohet dukshëm (Rubrika 3). Si rrjedhojë, kjo ka zvogëluar kostot e tregtimit për 20% (MTI, 2013).

Rubrika 3: Dokumentet e nevojshme për tregti ndërkufitare

Dokumentet e nevojshme për eksport:

-Dokumenti unik administrativ (d.m.th. deklarata doganore)

-Fatura komerciale

Dokumentet e nevojshme për import:

-Dokumenti unik administrativ (d.m.th. deklarata doganore)

-Fatura komerciale


-Certifikata e prejardhjes (për shtetet me të cilat Kosova ka tregti të lirë apo marrëveshje të tjera që mbulojnë përjashtimet bazuar në rregullat e prejardhjes).

5. Punësimi dhe kapacitetet njerëzore

5.1. Punësimi, pagat dhe struktura demografike e punëtorëve

Sipas të dhënave zyrtare (ATK, 2013), në vitin 2012, sektori i tekstitit punësonte rreth 1,453 persona, apo 0.7% të punëtorëve të regjistruar në Kosovë. Numri mestar i punëtorëve për ndërmarrje në vitin 2011 ishte 10 ndërsa në vitin 2012 ishte 14, ndërsa punësimi sipas mostrës së intervistuar ishte shtuar për 36% gjatë të njëjtës periudhë (Figura 14). Megjithatë, ky shtim i punësimit kishte ngjarë në vetëm një numër të vogël kompanish. Vlen të theksohet se 95% të vendeve të reja të punës të krijuara gjatë vitit 2012 (në krahasim me vitin paraprak) ishin krijuar nga tri kompanitë më të mëdha.

Figura 14: Rritja e kompanive (2011-2012) në bazë të numrit të punëtorëve



Sipas të dhënave nga anketa, në vitin 2012 paga mesatare në sektorin e tekstitit dhe lëkurës ishte €230. Mesatarisht, pagat janë më të larta në ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha (€250), ndërsa më të ulëta në kompanitë e vogla dhe të mesme (€183) (Figura 15 më poshtë).

Figura 15: Paga mesatare sipas madhësisë së kompanisë



Dallimet në pagën mesatare janë edhe më të dukshme nëse krahasohen nënsektorët e ndryshëm (Figura 16). Në kompanitë me veprimtari në prodhimin e veshjeve paga mesatare është €276, në ato që merren me prodhim të tekstilit dhe produkteve të lëkurës pagat mesatare janë €230, përkatësisht €161.

Figura 16: Paga mesatare sipas veprimtarisë së kompanisë



Burimi: Anketa e UNDP (2013)


Këto nivele relativisht të ulëta të pagave janë pjesërisht rezultat i rregulloreve fleksibile të tregut në Kosovë (Rubrika 4).

Rubrika 4: Rregulloret e tregut të punës

Kosova ka një treg fleksibil të punës me normë të ulët tatimore dhe kufizime të pakta në punësimin e punonjësve. Sistemi i normës së tatimit në të ardhura personale është sistem progresiv tatimor me normë prej 0-10 %. Përveç kësaj, vetëm një kontribut pensional prej 5% nga paga e plotë paguhet nga punëdhënësi (gjersa 5% të tjera nga paga e punonjësit). Që nga viti 2011, Kosova ka aplikuar një pagë minimale prej €170, apo €130 për individët nën moshën 35 vjeçe. Që nga viti 2011, marrëdhëniet e punës janë të rregulluara me ligjin e punës (nr. 03/L-212) i cili merr parasysh Konventat e ONP, legjislacionin e BE-së dhe parimet themelore të tregut të lirë dhe ekonomisë së lirë. Që nga viti 2013, shëndeti dhe siguria në punë rregullohen me ligjin për shëndetin dhe sigurinë në punë (nr. 04/L-161).

Sipas rezultateve të anketës, numri i punëtorëve të gjinisë femërore dhe mashkullore në këtë sektor është i barabartë. Shqiptarët përbëjnë 94% të tërë fuqisë punëtore (Figura 17), turqit dhe goranët janë pakicat më të punësuar në sektorin e tekstilit duke qenë se bashkërisht përbëjnë 5% të tërë fuqisë punëtore, ndërsa 1% i mbetur janë kryesisht serbë.


Figura 17: Struktura etnike e punëtorëve



Burimi: Anketa e UNDP (2013)

Të rinjtë përbëjnë më pak se 20% të fuqisë punëtore të angazhuar në këtë sektor (Figura 18), ndërsa shumica e punëtorëve është e moshës mes 26 dhe 50 vjeçare (60%).


Figura 18: *Struktura e punëtorëve sipas grupmoshave*



5.2. Kualifikimet e fuqisë punëtore

Rreth 70% të fuqisë punëtore në sektorin e tekstilit kanë të mbaruar shkollimin e mesëm, si nivel më të lartë arsimimi, ndërsa 23% kanë përfunduar arsimim terciar (Figura 19).

Figura 19: *Struktura e punëtorëve sipas nivelit të arsimimit*



Rreth 40% të ndërmarrjeve të anketuara i kanë identifikuar disponueshmërinë dhe koston e fuqisë punëtore të kualifikuar si probleme. Kjo çështje u nënvizua si problemi kryesor me të cilin përballet Kosovotex, siç edhe u përmend në Rubrikën 1. Edhe mungesa e punonjësve profesionistë me përgatitje profesionale shkollore duket se përbën një nga problemet specifike të përmendura në anketë. Megjithatë, kualifikimet e fituara nga të diplomuarit aktualisht (në nivel terciar apo sekondar profesional) konsiderohen si të pamjaftueshme për t'iu përgjigjur kërkesave të sektorit.

Profesionet specifike në sektorin e tekstit të cilat më së shpeshti përmenden si profesione ku mungojnë kuadro dhe për të cilat duhet zhvilluar profesionistë janë menaxhimi i prodhimit, kontrolli i cilësisë, përpunimi i lëkurës dhe gëzofit, dizajnerët, qepësit, kimistët dhe teknologët e tekstit. Profesione tjera në të cilat është raportuar se ka mungesë kuadros janë fushat e menaxhmentit, teknologjisë informative dhe mekanikëve elektrikë.


Ngjashëm me gjendjen në Kosovatex, që u shtjellua në Rubrikën 1, kompanitë tjera të tekstit gjithashtu duket se ofrojnë trajnime vetanake për të mbuluar mungesën e shkathtësive të stafit të tyre. Një nga kompanitë tjera gjithashtu raportoi se investon në zhvillimin e fuqisë së vet punëtore, përmes ofrimit të trajnimeve. Trajnimet kryesisht ofrohen në vend të punës, për të ngritur shkathtësitë specifike të nevojshme për prodhim. Format tjera të trajnimit (p.sh. trajnimet teorike) që fokusohen në njohuritë mbi prodhimtarinë dhe njohuritë e përgjithshme nuk janë edhe aq të shpeshta.

6. Asetet, investimet dhe inovacioni

Vlera e gjithmbarshme e aseteve të ndërmarrjeve të anketuara në vitin 2012 është parashikuar të jetë rreth €40 milionë. Raporti mesatar i intensitetit të kapitalit rezultoi të jetë 1.9.⁸ I njëjti ishte më i ulët për ndërmarrjet e vogla (0.67), se sa në ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha (1.21) apo në ndërmarrjet mikro (2.1).


Në përgjithësi, proporcioni që toka merr në asetet e gjithmbarshme është e ngjashme për kompani të madhësive të ndryshme, ndërsa proporcioni i makinerisë dhe pajisjeve në asetet e gjithmbarshme dallon varësisht prej madhësisë së ndërmarrjes (Figura 20).

Figura 20: Struktura e aseteve sipas madhësisë së ndërmarrjeve



Nga kompanitë që kanë raportuar asete, mesatarisht ndërmarrjet mikro kanë asete në vlerë prej €105,000, ndërsa ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha kanë asete në vlerë prej €440,000 përkatësisht €830,000.

Figura 21: Niveli mesatar i aseteve, sipas madhësisë së kompanisë (në €)




8 Intensiteti i kapitalit është kalkuluar si proporcioni mes vlerës së makinerisë dhe pajisjeve dhe shitjeve të kompanisë. Shitjet janë kalkuluar duke shfrytëzuar pikën mesatare të intervaleve përkatëse në pyetësor.

Një në pesë ndërmarrje të intervistuarra kishte raportuar realizim të investimeve gjatë vitit 2012. Vlera e gjithmbarshme e investimeve të tilla ishte €3.2 milionë, ndërsa të njëjtat kryesisht ishin përqendruar në blerjen e makinerive dhe pajisjeve të reja.

Ndërmarrjet në fushën e tekstilit gjithashtu raportuan aktivitet në inovacione të produkteve dhe proceseve (në marketing, metoda prodhimi dhe organizim). Rreth një në pesë kompani kishte raportuar se ka investuar në vënien në treg të ndonjë produkti të ri gjatë vitit 2012. Përveç tyre, 8% të ndërmarrjeve kishin paraqitur inovacione në marketing, kryesisht duke u fokusuar në përmirësim të dizajnit dhe paketim të produkteve (Figura 22). Gjashtë për qind kishin vënë në funksion metoda të reja prodhimi, ndërsa 3% kishin bërë ndryshime organizative.

Figura 22: Inovacionet



Burimi: Anketa e UNDP (2013)

Rreth 83% të kompanive të anketuara kishin raportuar se kanë së paku një patentë të regjistruar në Kosovë. Procesi i regjistrimit të patentave nuk konsiderohet se përbën pengesë për zhvillimin e biznesit nga të anketuarit. Në vijim është paraqitur një diskutim i shkurtër mbi pronën industriale dhe patentat në Kosovë (Rubrika 5).

Rubrika 5: Prona industriale dhe patentat në Kosovë

Të drejtat e pronësisë industriale: regjistrohen dhe administrohen nga Agjencia për Pronësi Industriale që vepron në kuadër të Ministrisë për Tregti dhe Industri.

Markat tregtare: janë të rregulluara me ligjin për markat tregtare (nr. 04/L-026). Pronari i markës së regjistruar tregtare, pas regjistrimit, do të ketë të drejta ekskluzive lidhur me mallrat apo/dhe shërbimet e mbuluara nga regjistrimi. Mbajtësi i markës tregtare ka të drejtë të parandaloj palët e treta të përdorin markën pa lejen e tij. Në veçanti, këto të drejta përfshijnë: shfrytëzimin e markës tregtare, autorizimin e një personi tjetër për shfrytëzimin e markës tregtare ose për të shfrytëzuar mjete juridike për shkelje të markës tregtare. Marka tregtare është e regjistruar për një periudhë prej 10 viteve dhe mund të rinovohet për një kohë të pakufizuar.


Dizajni industrial: rregullohet me Ligjin mbi Dizajnin Industrial (Ligji Nr.04/L-028) dhe dizajni është i mbrojtur me ligj deri në masën që është një risi dhe ka një karakter të veçantë. Mbrojtja e dizajnit industrial zgjatë pesë vite dhe mund të zgjatet maksimalisht për 25 vite.

Patentat: rregullohen me Ligjin mbi Patentat (Ligji Nr. 04/L-029). Një shpikje do të jetë e patentueshme nëse ajo është e re, përfshin një hap inventiv, dhe është e zbatueshme në industri. E drejta e patentës jepet për kohëzgjatje prej 20 viteve.

Kompanitë e intervistuarra konsiderojnë se procedurat e patentimit janë të thjeshta.

Megjithatë, mbi 40% të ndërmarrjeve të anketuara konsiderojnë se niveli i mbrojtjes së të drejtave intelektuale (eng. IPR) në Kosovë përbën pengesë për zhvillimin e kompanive në industrinë e tekstilit (Figura 23). Më saktësisht, 36% besojnë se (mungesa e) mbrojtjes IPR paraqet pengesë për zhvillimin e produkteve të reja, ndërsa 7% konsiderojnë se kjo përbën pengesë për kontraktimin e veprimtarisë së kompanive të tyre nga kompani të huaja.

Figura 23: Ndikimi i mbrojtjes IPR në zhvillimin e industrisë




Burimi: Anketa e UNDP (2013)

7. Mjedisi afarist

7.1. Pengesat për zhvillimin e ndërmarrjeve; perceptimet e ndërmarrjeve

Intensiteti mesatar i pengesave për zhvillimin e bizneseve, i raportuar nga ndërmarrjet e anketuara nga sektori i tekstilit, është paraqitur në vijim (Figura 24). Intensiteti matet në shkallë prej 0 deri 100, me atë që 0 paraqet nivelin më të ulët të intensitetit dhe 100 paraqet nivelin më të lartë të tij. Konkurrenca nga sektori joformal, kërkesa e ulët në tregun vendor, disponueshmëria dhe kostoja e energjisë dhe qasja në financa duket se paraqesin pengesat më të mëdha për rritje, ndërsa qasja në tokë, kostot e fuqisë punëtore, efikasiteti doganor dhe infrastruktura lokale joadekuate janë pengesat e radhitura më së ulëti.

Figura 24: Pengesat e zhvillimit të ndërmarrjeve



Burimi: Anketa e UNDP (2013)

Tek ndërmarrjet në të cilat së paku njëri pronar është grua vërehen fare pak dallime sa i përket intensitetit të pengesave të perceptuara nga ndërmarrjet. Këto ndërmarrje konsiderojnë se intensiteti më i lartë (rreth 10 për qind më shumë) qëndron tek pengesat si niveli i lartë i korrupsionit, cilësia e infrastrukturës lokale dhe kërkesa e ulët në tregjet lokale, se sa bizneset në pronë të burrave. Në anën tjetër, ndërmarrjet

që janë (pjesërisht) në pronësi të grave radhiten më ulët në shkallën e pengesave mbi cilësinë e lëndës së parë.


Megjithatë, dallime të mëdha raportohen tek intensiteti i disa pengesave për zhvillimin e bizneseve, nga këndvështrimi i ndërmarrjeve të madhësive të ndryshme (Figura 25).

Konkurrenca nga sektori joformal, për shembull, duket se përbën pengesë më serioze për ndërmarrjet mikro dhe të vogla se sa për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha. Kjo mund të shpjegohet nga 1) fakti se këto të fundit kanë më shumë gjasa që produktet e tyre t'i shesin në tregje të huaja dhe/ose 2) paaftësia e ndërmarrjeve më të vogla joformale për të konkurruar me cilësinë dhe sasinë e prodhuar nga ndërmarrjet më të mëdha.

Ndërmarrjet mikro nuk e radhisin sikur ndërmarrjet e vogla, mesme dhe mëdha koston dhe cilësinë e fuqisë punëtore, gjë që është e kuptueshme duke marrë parasysh se ato janë kryesisht ndërmarrje familjare. Si të tilla, ato kanë pak gjasa të prodhojnë produkte të cilësisë së lartë për eksport.

Në përgjithësi, ndërmarrjet e vogla kanë më shumë gjasa që të raportojnë intensitet të lartë për pengesat e jashtme (d.m.th. pengesat jashtë kompanisë). Intensiteti i **qasjes në financa** si pengesë është radhitur më së larti për ndërmarrjet e vogla, relativisht më ulët për ndërmarrjet mikro dhe pothuajse fare nuk ekziston tek ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha. **Pengesat institucionale**, siç janë niveli i korrupsionit, paaftësia e gjykatave dhe administratës tatimore, vlerësohen si probleme më serioze nga ndërmarrjet e vogla se sa nga ato mikro dhe të mesme/të mëdha.

Figura 25: Pengesat për zhvillimin e ndërmarrjeve, sipas madhësisë së tyre




Burimi: Anketa e UNDP (2013)

Gjasat më të mëdha që ndërmarrjet e vogla të raportojnë intensitet më të lartë të pengesave mund të sqarohet, së paku pjesërisht, përmes kombinimit të faktorëve kontekstualë. Në krahasim me homologët e tyre mikro, që kryesisht janë biznese familjare, ndërmarrjet e vogla konsiderohet se janë më ambicioze për rritje dhe, rrjedhimisht, preken më shumë nga qasja në financa, tokë dhe nga disponueshmëria dhe kostoja e energjisë. Në anën tjetër, ndërmarrjet më të mëdha mund të jenë në gjendje të marrin kredi bankare, por, mbase edhe më me rendësi, ato mund të raportojnë intensitet më të lartë për pengesa të tilla sepse 1) disa nga ndërmarrjet më të mëdha të këtij sektori janë pronë e shtetasve të huaj apo diasporës, dhe/ose 2) ato nuk varen nga financimi i jashtëm (nga bankat kosovare), siç është rasti i Kosovotex-it (shih Rubrikën 1 të këtij raporti).

Dallimet e intensitetit të pengesave për zhvillimin e bizneseve janë më pak të shfaqura dhe më pak të theksuara tek nënsektorët e ndryshëm (Figura 26). Kostoja e lëndës së parë dhe mallrave të papërpunuara, niveli i taksave, mosefikasiteti i doganave dhe administratës tatimore përbëjnë pengesa relativisht më të larta për ndërmarrjet prodhuese të tekstilit, ndërsa konkurrenca nga sektori joformal përbën pengesë relativisht më të lehtë për këtë sektor. Infrastruktura lokale, qasja në financa dhe tokë janë radhitur si më intensive nga ndërmarrjet e sektorit të lëkurave se sa nga ndërmarrjet homologe nga sektori i tekstilit dhe veshjeve.

Figura 26: Pengesat për zhvillimin e ndërmarrjeve, sipas veprimtarisë



Burimi: Anketa e UNDP (2013)

Rubrikat 6, 7 dhe 8 në vijim ofrojnë informata mbi institucionet relevante publike dhe shoqatat afariste; rregulloret specifike të këtij sektori; dhe lejet dhe certifikatat e sektorit.

Rubrika 6: Institucionet relevante

- *Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (regjistrimi i biznesit), <http://www.arbk.org/>*
- *Agjencia për Promovimin e Investimeve të Kosovës (informatat investitorët e huaj për fillimin e biznesit, mundësitë e biznesit, partnerët potencialë të biznesit, etj.), <http://www.invest-ks.org/>*
- *Administrata Tatimore e Kosovës (pagesa e tatimeve), <http://www.atk-ks.org/>*
- *One-stop-shopet” komunale (burime të informatave për biznese dhe ofrimi i shërbimeve konsulente)*
- *Doganat e Kosovës (informata për detyrimet dhe procedurat doganore), <https://dogana.rks-gov.net>*
- *Shoqatat afariste (rrjetet e biznesit, panairet, misionet tregtare, avokim, etj.): Oda ekonomike; Oda Ekonomike Amerikane; Alenanca Kosovare e Biznesit.*
- *Shoqata e Sektorit të Tekstilit “K-TEX” (takime B2B, avokim për sektorin, etj.)*

Rubrika 7: Rregulloret relevante specifike për sektorin¹

- *Rregullore nr. 1/2012 për metodat e analizave sasiore të përzierjeve treshe të fijeve të tekstilit*
- *Rregullore nr. 10/2012 për etiketimin e materialeve që përdoren për komponentët kryesorë të mbathjeve për shitje për konsumatorët*
- *Rregullore nr. 11/2012 për përmbajtjen e lëndës së parë dhe etiketimit të tekstilit.*
- *Rregullore nr. 12/2012 për metodat e analizave sasiore të përzierjeve dyshe të fijeve të tekstilit.*


¹ Korniza relevante ligjore mund të shkarkohet në adresën: <http://www.mti-ks.org/sq/Legjislacioni>

Rubrika 8: Lista e lejeve dhe certifikatave përkatëse

- *Certifikata e biznesit*
- *Regjistrimi për TVSH*
- *Regjistrimi i punonjësve për skemën pensionale me Administratën Tatimore*
- *Vërtetimi i mbrojtjes nga zjarri*
- *Vërtetimi për ujë*
- *Leja e ndërtimit*
- *Lidhja në energji elektrike*

Pesëdhjeteshtatë për qind të ndërmarrjeve të intervistuar besojnë se niveli i tati-
meve është 'i lartë' ose 'shumë i lartë', megjithatë, vetëm 16% konsiderojnë se tatimet
janë 'shumë të larta' (Figura 27).


Figura 27: Perceptimet e ndërmarrjeve mbi nivelin e tati-
meve



Burimi: Anketa e UNDP (2013)

Një në pesë ndërmarrje mendon se performanca e Administratës Tatimore të
Kosovës është 'joefikase' apo 'shumë joefikase', ndërsa vetëm 1.7% e vlerësojnë atë si
'shumë joefikase' (Figura 28).


Figura 28: Perceptimet e ndërmarrjeve mbi performancën e Administratës Tatimore të Kosovës



Burimi: Anketa e UNDP (2013)

Përqindja e atyre që performancën e Doganave e vlerësojnë si 'joefikase' apo
'shumë joefikase' është paksa më e lartë - 29%; ndërsa, vetëm 5.8% e vlerësojnë atë si
'shumë joefikase' (Figura 29).

Figura 29: Perceptimet e ndërmarrjeve mbi performancën e Doganave



Informatat mbi nivelin e tatimeve dhe përjashtimeve tatimore përkatëse janë ofruar në vijim (Rubrikat 9 dhe 10).

Rubrika 9: Tatimet relevante


- Tatimi në korporatë: 10%
- Tatimi në të ardhura personale: €0-€80=0; €80-€250=4%; €250-€450=8%; €450 dhe më shumë =10%
- TVSH: 16%
- Dogana: 10%
- Tatimi në pronë: ndërmjet 0.05% dhe 1% të vlerës së tregut.

Rubrika 10: Masat stimuluese për sektorin

- Nuk ka masa specifike stimuluese për sektorin, por në vijim janë ato të përgjithshmet:
- Nuk ka detyrime doganore në importet e teknologjisë
- Përmes autorizimit të depove doganore, ekziston mundësia që bizneset t'i pezullojnë pagesat e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) në lëndën e parë deri në periudhën kur mallrat trajtohen dhe në rast se mallrat e importuara rieksporthen nuk paguhen fare taksa
- Mundësi për t'i shtyrë pagesat e TVSH-së në importet në pajisje dhe makineri të caktuara deri në 6 muaj (për të lejuar që pajisjet dhe makineritë të kenë hyrë në operim para se të paguhet TVSH-ja në koston e tyre)
- Marrëveshjet për lehtësim dhe promovim të eksportit të dizajnuara për të siguruar përfitimë për bizneset kosovare përmes lirimit nga detyrimet e importit për prodhimin e mallrave në Kosovë, të cilat eksporthen më pas: kthim, përpunim të brendshëm dhe procedurat e përpunimit të jashtëm. Për përpunim të brendshëm dhe përpunim të jashtëm, periudha e vlefshmërisë së autorizimit normalisht nuk duhet të kalojë tre vjet.


Gjashtëdhjetenjë për qind të ndërmarrjeve të intervistuar perceptojnë se sigurimi i financave është 'i vështirë' ose 'shumë i vështirë', ndërsa një e katërta e tyre besojnë se ai është 'shumë i lehtë' (Figura 30).

Figura 30: Perceptimet e ndërmarrjeve sa i përket lehtësisë së financimit



Ngjashëm me këtë, rreth 54% të ndërmarrjeve mendojnë se kostoja e financimit është 'e lartë' ose 'shumë e lartë', ndërsa gjysma e tyre e vlerësojnë atë si 'shumë të lartë' (Figura 31).

Figura 31: Perceptimet e ndërmarrjeve mbi koston e financimit



Në vijim janë ofruar informata mbi koston e financimit në Kosovë (Rubrika 11).

Rubrika 11: Kostoja e financimit dhe kërkesat për kredi

- Nuk ka norma specifike të kamatës për tekstilin apo për sektorin e prodhimit në tërësi. Norma efektive e kamatës, për kreditë e reja në Tetor 2013 ishte 11.7% (Banka Qendrore e Kosovës, 2013). Norma efektive e kamatës në kreditë investuese me maturitet deri në pesë vite është më ulët se 10.2%. Për të marrë kredi, bizneset duhet të kenë Certifikatë të Regjistrimit të Biznesit (të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë), Certifikatë të TVSH dhe informatat për të dhënat financiare të kompanisë.

Konkluzionet

Qëllimi i këtij raporti ishte që të ofrojë një profil të industrisë të tekstitit (përfshirë lëkurën), si dhe të pengesave të zhvillimit të kësaj industrie, duke u përqendruar në pengesat për realizim të eksportit.

Ndërmarrjet prodhuese të tekstitit dhe lëkurës në Kosovë janë të përqendruara kryesisht në rajonet e Prizrenit, Gjakovës dhe Prishtinës. Rreth gjysma e ndërmarrjeve të këtij sektori kanë si veprimtari prodhimin e veshjeve, përcjellë nga prodhimi i tekstitit dhe produkteve të lëkurës. Megjithatë, prodhimi i veshjeve dhe tekstitit gjenerojnë një numër të ngjashëm të vendeve të punës. Prodhuesit e produkteve të lëkurës, përfshirë përgatitjen dhe tharjen e lëkurave, përbëjnë sektorin më të vogël edhe sa i përket numrit të ndërmarrjeve edhe punësimit, por edhe sektorin më të madh sa i përket eksporteve.

Në vitin 2012, sektori i tekstitit punësonte rreth 0.7% të punëtorëve të regjistruar në Kosovë. Ai punëson numër të barabartë të grave dhe burrave. Së paku rreth një të katërtës së ndërmarrjeve të anketuara janë pronë e grave. Nga ky numër, 54% janë pronë ekskluzive e grave. Shumica e të punësuarve në këtë sektor (60%) janë të moshës mes 26 dhe 50 veç. Shqiptarët e Kosovës përbëjnë 94% të fuqisë punëtore të angazhuar në këtë sektor, ndërsa turqit dhe goranët përbëjnë pakicat më të punësuarra në të. Sipas rezultateve të anketës, paga mesatare në sektorin e industrisë dhe lëkurës në vitin 2012 ishte €230.

Vlera mesatare e supozuar e rezultateve të ndërmarrjeve të këtij sektori është €244,000. Sektori dominohet nga ndërmarrjet tejet të vogla. Në vitin 2012, dy të tretat e ndërmarrjeve raportuan të kenë rezultatet me vlerë prej nën €25,000, ndërsa 10% kanë raportuar të kenë rezultatet mes €100,000 dhe €10 milionë. Vlera e rezultatit të sektorit është shtuar për 18% mes vitit 2011 dhe 2012, dhe kjo rritje duket të jetë nxjerrur nga prodhimi i tekstileve dhe produkteve të lëkurës.

Punësimi në këtë sektor është shtuar kohëve të fundit - me 36% në vitin 2012 në krahasim me vitin paraprak, megjithatë, rritja nuk ka qenë e ndarë në mënyrë të njëtrajtshëm në tërë sektorin. Vetëm disa ndërmarrje të mëdha, shumica prej të cilave janë pronë e shtetasve të huaj, krijuan shumicën e vendeve të reja të punës në këtë sektor gjatë vitit 2012. Numri mesatar i punëtorëve nëpër ndërmarrje është rritur nga 10 në vitin 2011 në 14 në vitin 2012.

Mallrat ndihmëse dhe lënda e parë që shfrytëzohen nga ndërmarrjet kosovare në sektorin e tekstitit kryesisht importohen. Këto importe kryesisht përbëhen nga produkte ndihmëse si pambuku, leshi dhe fjetet tjera, lëkura dhe penjtë për qepje. Niveli mesatar i shfrytëzimit të kapaciteteve në sektorin e tekstitit dhe lëkurës në vitin 2011 ishte 57%. Rreth 45% të ndërmarrjeve të intervistuar raportuan se produktet e tyre i shesin ekskluzivisht tek distributorët/shitësit me shumicë dhe pakicë, ndërsa 22% të ndërmarrjeve tjera ua shesin produktet e veta ekskluzivisht konsumatorëve fundorë.

Rreth 10% të ndërmarrjeve të tekstilit eksportojnë në vende tjera. Eksportet kryesore të këtij sektori janë lëkurat dhe mbathjet, fjetet e leshit dhe fjetet e tjera dhe veshjet (siç janë xhinset dhe çorapet). Destinacion kryesor i eksporteve të tekstilit të Kosovës janë Italia (kryesisht për lëkura), Gjermania (kryesisht për fije, veshje dhe mbathje) dhe shtetet fqinje si Shqipëria, Bosnja e Hercegovina dhe Serbia (kryesisht fije dhe veshje). Siç u raportua nga ndërmarrjet eksportuese të anketuara, pengesat kryesore janë kostot e transportit, procedurat joefikase doganore, garancitë e kushtueshme bankare dhe vështirësitë në arritjen e standardeve ndërkombëtare të cilësisë.

Ndërmarrjet e anketuara nuk konsiderojnë se regjistrimi i patentave është i vështirë apo përbën pengesë për zhvillimin e ndërmarrjeve. Megjithatë, ndërmarrjet vlerësojnë se niveli i mbrojtjes së të drejtave të pronës intelektuale (IPR) përbën pengesë për zhvillimin e ndërmarrjeve që veprojnë në këtë industri.

Rreth 40% të ndërmarrjeve të anketuara të sektorit të tekstilit e identifikojnë disponueshmërinë dhe koston e fuqisë punëtore të kualifikuar (përfshirë edhe Kosovatek, që vlerëson se ky faktor përbën pengesën më të madhe për zhvillimin e ndërmarrjeve në Kosovë). Profesionet specifike për të cilat sektori vlerëson se ka më së shumti mungesë për profesionistë janë ato në menaxhim të prodhimit, kontroll të cilësisë, përpunim të lëkurës dhe gëzofëve, dizajn, qepje, kimi dhe teknologji tekstili.

Konkurrenca nga sektori joformal, qasja në financa dhe kërkesa e ulët në vend konsiderohen pengesat kryesore për rritje të biznesit, ndërsa qasja në tokë, kostoja për fuqi punëtore, efikasiteti i doganave dhe infrastruktura lokale janë mes pengesave më të parëndësishme. Megjithatë, ekzistojnë dallime të theksuara në intensitetin e raportuar të pengesave të caktuara nga ndërmarrjet e madhësive të ndryshme. Konkurrenca nga sektori joformal, për shembull, duket se paraqet pengesë shumë serioze për ndërmarrjet mikro dhe të vogla se sa për ato të mesme dhe të mëdha. Intensiteti i qasjes në financa si pengesë shfaqet më i lartë tek ndërmarrjet e vogla, relativisht më i ulët për ndërmarrjet mikro dhe pothuajse inekzistente për ndërmarrjet e mesme dhe të larta. Ndërmarrjet mikro nuk vlerësojnë se kostoja dhe cilësia e fuqisë punëtore përbën pengesë të madhe në krahasim me ndërmarrjet e vogla, të mesme dhe të mëdha. Pengesat si niveli i korrupsionit, mosefikasiteti i gjykatave dhe ATK-së, qasja në financa, disponueshmëria dhe kostoja e energjisë, dhe qasja në tokë konsiderohen si pengesa më serioze të rritjes nga ndërmarrjet e vogla se sa nga ndërmarrjet mikro dhe të mesme/të mëdha. Mbi 50% të ndërmarrjet të intervistuar besojnë se niveli i tatimeve të zbatueshme është i 'lartë' ose 'shumë i lartë.'

Referencat

ARBK, 2013. Baza e të dhënave e Bizneseve të Regjistruara pranë Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës. Prishtinë: ARBK

MTI, 2013. Faqja e MTI në internet. <http://www.mti-ks.org/sq/Reformat-e-te-berit-biznes>. [vizituar më 5 janar 2014]

ATK, 2013. Baza e të dhënave e Bizneseve të Regjistruara pranë Administratës Tatimore të Kosovës. Prishtinë: ATK.

Anketa e UNDP, 2013. Anketa e kompanive në sektorin e tekstilit. Prishtinë: UNDP.





MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË

www.mti-ks.org